



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 749/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesues, Afijete Sada- Gllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur lidhur me apelin e Kosovare Murseli, kandidate për deputete nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.749/2021 i datës 05.03.2021, i ushtruar nga Kosovare Murseli, kandidate për deputete nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, i ushtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet: 1819E/01,02, 1812E/01, 02, 03, 1807E, 1815E/01, 02, 1803E/01, 02, 1802E, 1816E/01, 02, 1701C/01R, 02R, 03R, 04R, 05R, 06D, 1704X/01R, 02R, 03R, 04R, 05R, 06R, 07R, 08R, 09/D, 1705C/01R, 02R, 03R, 04R, 05R, 06D, 1705X/01R, 02R, 03R, 04D, 1723C/03R, 02D, 03R, 04R, 05R, 06R, 07R, 08D, 1703C/01R, 02R, 03R, 04D, 0409D/02R, 0509D/03R, 0409D/02R, 04R, 05D, 0509D/03R, 0407D/01R, 02R, 03R, 04D, 2101B/01R, 02R, 03R, 04R, 05D, 2131B/01D.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 05.03.2021, ka pranuar apelin Anr.749/2021 nga Kosovare Murseli, kandidate për deputete nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se administrimi i procesit zgjedhorë që nga numërimi në vendvotim dhe administrimi i këtij procesi në QNR është përcjellë fatkeqësisht me lëshime, gabime e të cilat rezultuan me pasaktësi në rezultatin e sajë. Më tutje pretendon se është dëmtuar me rezultatin e shpallur duke marrur parasysh se është kandidate potenciale për të fituar ulëse në Kuvendë. Andaj kërkon nga PZAP që të rinumërohen këto vendvotime: 1819E/01,02, 1812E/01, 02, 03, 1807E, 1815E/01, 02, 1803E/01, 02, 1802E, 1816E/01, 02, 1701C/01R, 02R, 03R, 04R, 05R, 06D, 1704X/01R, 02R, 03R, 04R, 05R, 06R, 07R, 08R, 09/D, 1705C/01R, 02R, 03R, 04R, 05R, 06D, 1705X/01R, 02R, 03R, 04D, 1723C/03R, 02D, 03R, 04R, 05R, 06R, 07R, 08D, 1703C/01R, 02R, 03R, 04D, 0409D/02R, 0509D/03R, 0409D/02R, 04R, 05D, 0509D/03R, 0407D/01R, 02R, 03R, 04D, 2101B/01R, 02R, 03R, 04R, 05D, 2131B/01D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Kosovare Murseli, kandidate për deputete nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, ka paraqitur apel Anr.749/2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet: 1819E/01,02, 1812E/01, 02, 03, 1807E, 1815E/01, 02, 1803E/01, 02, 1802E, 1816E/01, 02, 1701C/01R, 02R, 03R, 04R, 05R, 06D, 1704X/01R, 02R, 03R, 04R, 05R, 06R, 07R, 08R, 09/D, 1705C/01R, 02R, 03R, 04R, 05R, 06D, 1705X/01R, 02R, 03R, 04D, 1723C/03R, 02D, 03R, 04R, 05R, 06R, 07R, 08D, 1703C/01R, 02R, 03R, 04D, 0409D/02R, 0509D/03R, 0409D/02R, 04R, 05D, 0509D/03R, 0407D/01R, 02R, 03R, 04D, 2101B/01R, 02R, 03R, 04R, 05D, 2131B/01D.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.749/2021, provave të bashkangjitura në apel, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Kosovare Murseli, kandidate për deputete nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Gjithashtu ankuesi në apel nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi apo në veçanti ndonjë dëshmi lidhur me ndonjë vendvotim ku pretendon se është bërë gabim në bartjen e rezultateve për kandidat, apo ku është dëmtuar sa i përket votave të numëruara. Në rastin konkret paneli vlerëson se një pretendim i tillë i përgjithësuar është tërësisht i pa bazuar dhe i pa argumentuar, për faktin se pala ankues nuk ka ofruar asnjë dëshmi, qoftë ndonjë formular apo provë tjetër që do të bënte apelin të bazuar, andaj mbi një gjendje të tillë të fakteve paneli e refuzoi apelin në tërësi si të pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Kosovare Murseli e subjektit politik PDK, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat për aq më tepër duke konsideruar se ligjërisht vota është e fshehtë dhe votuesit janë të lirë që të përzgjedhin kandidatët për të cilët votojnë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 749/2021 më datën 06.03.2021

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj

***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*

